

## Zgjidhja e Konflikteve

Kur njerëzit bëhen bashkë dhe rrinë bashkë, do të lindin konflikte; kjo gjë është normale.

*(shënim për pastorin: tregim personal i ndonjë konflikti kohët e fundit)*

Në çdo lloj marrëdhënie, kudo ku ka njerëz, ka tensione dhe konflikte. Konflikti mund të ndodhi mes teje dhe një shoku, mes teje dhe pronarit, mes teje dhe fëmijëve të tu, mes teje dhe të dashurit/të dashurës, mes teje dhe prindërve, mes teje dhe motrave e vëllezërve.

Problemi në konflikt është: Unë nuk dua të humbas! Dua ta fitoj konfliktin! Kjo sjell shumë probleme. Sepse edhe personi nga ana tjetër do ta fitojë këtë konflikt. Nëse ka dy persona dhe të dy duan të fitojnë, a e gjen se çfarë ndodh? Shpërthen një sherr i madh! Dhe kjo është e keqja e konfliktit.

Sot do të shikojmë 5 lloje konfliktesh, dhe për ta ilustruar bukur këtë, do të përdorim 5 lloje kafshësh. Ndërsa unë flas, pyete veten: Ku je ti më shumë? Ku anon ti më shumë? Jo cila nga këto është më e bukur apo më e fortë, por cila ka ngjashmëri më të madhe me ty. I pari:

### Rinoceronti

Rinoceronti është gati për konflikt. Nëse e shikon në YouTube, shpesh e sheh që rinocerontët zihen me elefantët, dhe rinoceronti sulmon i pari. Ai e ndjen problemin dhe pastaj e provokon problemin që ka dalë. A ngjan me këtë ti? E shikon problemin dhe hidhesh për ta zgjidhur, nuk pret. Por puna është se njerëzit rreth teje nuk janë të gjithë si ti; disa prej tyre kanë nevojë për më shumë kohë, për t'u qetësuar dhe për të biseduar përpara se të hidhen për ta zgjidhur problemin.

E mira e rinocerontëve dhe atyre që ngjajnë me ta është se këta persona e nxjerrin problemin në dukje, nuk kanë të fshehta. Po patën ndonjë gjë që nuk u pëlqen, e plasin mu para syve. Janë transparentë.

### Iriqi

Kur sulmohet nga ndonjë gjë dhe kur dalin probleme, iriçi mblidhet si një top. Nuk do të përballet me problemin dhe rri i mbledhur për disa orë ose për një kohë më të gjatë. Personat e tillë janë të kuptueshëm; nuk e kërkojnë konfliktin, POR e kanë të vështirë të hapen dhe nuk duan të shpërthejnë. Sa ndjejnë një problem, mbyllën në vetvete dhe nuk e bëjnë të qartë se çfarë mendojnë. Sidomos kur burri është si rinoceronti dhe gruaja si iriçi, ai do të debatojë,

ndërsa ajo vetëm tkurret dhe mblidhet si iriqi, dhe nuk arrijnë të merren vesh, çka krijon probleme. Por e mira e iriqit është se këta persona e duan harmoninë dhe paqen; janë të qetë.

## **Gorilla**

Gorilla kujdeset për tufën e saj. Shumicën e herëve, gorilla është e qetë. Por nëse e kalon cakun, nëse i hyn në hak gorillës, ajo fillon dhe bën namin. Gorilla lufton deri në pikën e fundit për të fituar. Ajo duhet të fitojë luftën pa tjetër. Në rastin tonë, le të themi që ti je në një takim pune me drejtorin ose pronarin, dhe ai ka tipin si gorilla që do të fitojë të gjitha debatet me punonjësit ose nxënësit. Dhe në mes të mbledhjes thua, “A mund ta ndryshojmë filan gjë, filan datë, ose filan projekt?” Po e gjete çfarë ndodh?

Ana e mirë e gorillës është se ajo bën gjëra që nuk i bën dot ndonjë kafshë tjetër; nuk heq dorë nga bindjet e veta dhe është e gatshme dhe e fuqishme. Përballet me çfarë t’u dalë përpara.

Të kesh një person të tillë në skuadër është super. POR, nëse e di që ke një person të tillë, mos e ngacmo, mos e sulmo, sepse pastaj duhet t’i hapësh krahun.

## **Gjirafa**

Gjirafa është e gjatë dhe shikon larg. A e di ti se gjirafat zihen me njëra-tjetrën? Tipat si gjirafa ngordhin për të analizuar problemet. Ato dinë zgjidhjen e çdo problemi dhe kanë përgjigje për gjithçka. Mund të komunikojnë mirë.

E keqja është se kur këta tipa kanë përgjigje për çdo problem, ata nuk janë të vëmendshëm kur flet dikush tjetër, sepse nuk janë dëgjues të mirë. Janë të shpejtë në të folur, por shumë të ngadaltë në të dëgjuar.

Ana pozitive është se këta tipa dinë t’i zgjidhin mirë problemet që dalin.

## **Struci**

Struci është modeli i fundit nga llojet e konflikteve. Struci është i fortë, vrapon shpejt, por nuk fluturon dot. Kur fillon stuhia e rërës në shkretëtirë, e di çfarë bën struci? E fsheh kokën në rërë!

Për tipat si struci, ditët janë gjithmonë të bukura, sepse kur vjen ndonjë ditë e vështirë, ata e fusin kokën në rërë. Nuk ka probleme në këtë botë për ta. Janë gjithmonë pozitive dhe inkurajues, gjithmonë të qeshur dhe të dashur, dhe u rrijnë larg konflikteve. E mira e këtyre personave është se ata shikojnë anët pozitive të njerëzve përreth, shikojnë potencialin që ka çdo person.

Tani, cila nga këto pesë është më afër teje? Me kë ngjan më shumë?  
Duke qenë se nuk jemi të gjithë njësoj dhe jemi të ndryshëm, duhet të mësojmë sesi të mos qëndrojmë vetëm në bunkerin tonë deri sa të na dalë e jona, por të mësojmë si të:

### **Zgjidhim Problemin Pa E Sulmuar Personin Tjetër.**

Nëse rrimë të dy në bunkerët tanë dhe nuk lëvizim, nuk marrim hapa për të ndryshuar dhe për të komunikuar me tjetrin, nuk kemi për t'u përmirësuar, dhe konfliktet do të vazhdojnë për shuumë kohë. Si duhet të ndryshojmë, çfarë nënkupton kjo për tipat e ndryshëm, dhe cilat janë mënyrat e ndryshme si merremi me konfliktin?

P.sh., për rinocerontin, duhet të kuptojë se jo të gjitha problemet mund të zgjidhen tani, duhet t'i japë kohë njerëzve dhe të kuptojë kur është momenti i duhur për t'u marrë me problemin që doli. Ka disa probleme që nuk duhen zgjidhur "o tani o s'ka". Duhet t'i japë njerëzve të tjerë kohën që u duhet.

Për iriqin, do të thotë se duhet të dalë nga bota e vet, të hapet, dhe të tregojë se çfarë e ka lënduar, çfarë e gëzon.

Për gorillën, do të thotë se nuk ka gjithmonë të drejtë dhe nuk duhet të jetë patjetër fitues çdo herë. Duhet të lejoj të tjerët të fitojnë dhe ta kenë ata fjalën e fundit.

Për gjirafën, duhet të mësohet si t'i dëgjojë më shumë të tjerët dhe të flasë më pak.

Për strucin, është e qartë besoj, të nxjerrë kokën jashtë, ta shikojë problemin në sy dhe të përballet me të dhe jo të fshihet. Të mos i injorojë, por t'i zgjidhë problemet.

Bibla është plot me raste konfliktesh që kanë patur njerëzit ndër shekuj. Madje në kapitujt e parë, dhe me njerëzit e parë në Bibël pati konflikte, le të lexojmë nga Zanafilla 4, ja se çfarë thuhet aty.

*Me kalimin e kohës, Kaini i bëri një ofertë frutash të tokës Zotit; por Abeli i ofroi edhe ai të parëlindurit e kopesë së tij dhe yndyrën e tyre. Dhe Zoti e çmoi Abelin dhe dhuratën e tij, por nuk çmoi Kainin dhe ofertën e tij.*

*Dhe kështu Kaini u pezmatua shumë dhe fytyra e tij mori një pamje të dëshpëruar. Atëherë Zoti i tha Kainit: "Pse je pezmatuar dhe pse fytyra jote është dëshpëruar?"*

*Në rast se bën mirë a nuk do të pranohesh? Por në qoftë se bën keq, mëkati po*

*të ruan te porta dhe dëshirat e tij drejtohen ndaj teje; por ti duhet ta sundosh".*  
Zanafilla 4:4-7

Dhe ju e dini si përfundon historia, nuk pati fund të bukur. Ajo që është interesante është se Perëndia e konfrontoi Kainin dhe i tha: "E shikoj që je i zemëruar. Të zemërosh është normale; është pjesë e jetës, dhe të lëndohesh është gjithashtu pjesë e jetës." Pyetja është: Si merremi me zemërimin dhe me lëndimet që marrim?

Perëndia e konfrontoi Kainin dhe i tha: "Ti je i zemëruar, por ka rrugëzgjdhje." Dhe rrugëzgjdhja vinte në dy drejtime. E para do e çonte Kainin në shkatërrim. Kur e lejojmë zemërimin të na kontrollojë, në këtë rast do të lëndojmë veten dhe të tjerët. Por Perëndia thotë se ka një mënyrë tjetër, që është: "Ti duhet ta sundosh atë, zemërimin."

*(shënim për pastorin: trego një rast personal si e ke ndaluar zemërimin të të kontrollojë)*

Bibla thotë, *Zemërohuni dhe mos mëkatoni; dielli të mos perëndojë mbi inatin tuaj;* Efesianëve 4:26

Zemërimi nuk është mëkat; jemi njerëz prej gjaku e mishi. Por, nëse shkon dhe pajtohesh brenda ditës, sepse nëse fle gjumë i zemëruar, të nesërmen ai zemërim do të të kontrollojë dhe do të kesh shumë më të vështirë ta falësh personin tjetër.

**Mos e humb respektin për të tjerët!** Perëndia na ka rrethuar me njerëz dhe Ai do që të respektojmë njëri-tjetrin. Disa herë, njerëzit që e kam më të vështirë t'i respektoj janë ata që i dua më shumë, ata që janë më të afërt. Dhe nga këta njerëz e humbet respektin më shpejt. Perëndia do që të mos e humbim respektin për të tjerët.

A dëshiron të humbasësh shpejt respektin që dikush ka për ty? Kritikoje personin që do para të tjerëve dhe niveli i respektit që ai ka për ty bie me shpejtësi.

*Mos bëni asgjë për rivalitet as për mendjemadhësi, por me përulësi, secili ta çmojë tjetrin më shumë se vetveten.* Filipianeve 2:3

Çfarë do të thotë "më shumë se veten"? Kjo do të thotë të heqësh dorë nga synimi për të fituar çdo konflikt dhe të lejoësh tjetrin të fitojë.

**Merr përgjegjësi për veprimet e tua!**

Dikush ka thënë: Kur ti lëndohesh, natyrshëm mendon se personi që të ka lënduar ka 90% të fajit dhe ti ke vetëm 10% të fajit. Por edhe nëse kjo është e vërtetë, atë 10% tëndën e merr 100% seriozisht. Kjo është sfiduese nganjëherë, sepse ti mund të mendosh: “Po, unë gati s’kam faj, ose kam bërë një faj të vogël.” Por Perëndia do që të jesh përgjegjës për atë 10% të fajit tënd.

Kur ndodhin gjëra të tilla, shko te Perëndia dhe thuaji: “Zot, cila është pjesa që unë duhet të rregulloj?” Sepse në një konflikt, është e sigurt që edhe ti ke një përqindje faji në atë që ndodhi. Dhe Ai do që të jesh përgjegjës për atë gjë.

Dhe është shumë e vështirë kur shkon të kërkosh falje, sidomos kur personi tjetër të ka lënduar shumë.

*Por jini të mirë dhe të mëshirshëm njeri me tjetrin, duke e falur njëri-tjetrin, sikurse edhe Perëndia ju ka falur në Krishtin. Efesianëve 4:32*

Ndërsa i lutemi Perëndisë, në lidhje me atë marrëdhënie të prishur dhe atë konflikt, duhet të pyesim: Cila është pjesa ime? Çfarë duhet të ndryshoj, çfarë duhet të bëj ndryshe?

Nëse Perëndia po të sfidon për të falur atë person, fale që sonte!

Zoti do që të kesh një zemër të shëruar dhe do që të merresh me konfliktet ashtu siç duhet!

Le të lutemi!